

AKT THEMELIMI

I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“D.U.M PROJECT ALBANIA” SH.P.K.



NENI 1 FORMIMI

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “D.U.M PROJECT ALBANIA” SH.P.K. themelohet në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”. Kjo shoqëri krijohet nga:

1. Z.Stefano Mari, i biri i Maurizio-s dhe Virginia-s, i datëlindjes 22.12.1981, lindur në Tradate (VA), Itali, banues në Adresën Via. Garibaldi, 58, 22070 Locate Varesina (CO) Itali, i identifikuar me Numër Pasaporte YA2779546, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Organi administrues i Shoqërisë ka të drejtë të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe jashtë saj.

NENI 2 SELIA

Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “D.U.M PROJECT ALBANIA” SH.P.K. është në adresën: **Rr. “Riza Cerova”, Nd 18, H 5, Njësia Administrative 8, 1017 Tiranë, Shqipëri.**

Ortaku mund të vendos për transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër.

NENI 3 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “D.U.M PROJECT ALBANIA” SH.P.K. është e pacaktuar.

NENI 4 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “D.U.M PROJECT ALBANIA” sh.p.k. do të jetë:

- a) Shërbime telemarketingu. Ofrimin e të gjitha shërbimeve që lidhen me call-center dhe kontakt center duke përfshirë edhe përpunimin e të dhënave të shoqërive të tjera dhe/ose enteve publike, ndërmjetësimin tregtar dhe marketing në fushën e shërbimeve telematike dhe telefonike. Aktivitete të shërbimeve të ndërmjetësimit midis shoqërive private brenda dhe jashtë vendit.
- b) Shërbime trajnimi dhe edukimi në fushën e teknologjisë së informacionit. Shtypshkrime, botime, printime dhe fotokopjime. Përfaqësim të kompanive të

huaja që ushtrojnë aktivitet në Shqipëri ose jashtë saj. Të kryejë aktivitet publikimi dhe reklamimi.

- c) Shërbime të menaxhimit të projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.
- d) Krijimi mbajtja dhe mirëmbajtja e faqeve të internetit. Krijimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve informatike dhe aplikimeve të ndryshme. Krijimi i logove të ndryshme si atyre, postare, broshurave, sportive, publicitare dhe çdo gjë tjetër që lidhet me konceptimin, realizimin, promovimin, prodhimin dhe shitjen e tyre në mediën e shkruar, atë vizive dhe atë elektronike.
- e) të prodhojë, përpunojë, blejë, shesë, shkëmbejë, ndryshojë, përmirësojë, importojë, eksportojë ose ndryshe të merret me të gjitha llojet e pajisjeve elektrike, pajisjet për kursimin e energjisë, produktet e energjisë diellore, pajisjet dhe komponentët për përdorim komercial dhe shtëpiak;
- f) Të ofrojë shërbime online dhe offline, si në vend ashtu edhe jashtë saj, për të arritur tek klientët, furnizuesit dhe bashkëpunëtorët e tij, drejtpërdrejtë dhe përmes ndërmjetësve, zëdhënësve, agjencive dhe përfaqësuesve;
- g) Të ofrojë asistencë online dhe telefonike, të zhvillojë faqe-uebi dhe portale, aplikacione mobile dhe e-commerce, për të lehtësuar misionin e saj dhe si shërbim për klientët e saj, sipas nevojës. Kjo do të përfshijë, por pa u kufizuar në, dhënia me qira e pajisjeve elektronike dhe/ose objekteve që kërkohen për aktivitete promovuese.
- h) Të marrin pjesë në tenderat publike dhe private për furnizimin dhe shpërndarjen e të gjitha sendeve që kanë të bëjnë me industrinë e teknologjisë së informacionit, prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve promovionale, si dhe pajisjet e tjera përkatëse;
- i) të pranojë dhe të japë honorare, të drejta, licenca ose prona të ngjashme intelektuale ose të tjera të çfarëdo lloji dhe të lidhë marrëveshje për këtë qëllim;
- j) Të promovojë, financojë, organizojë ose të trajtojë në ndonjë mënyrë tjetër, çdo projekt, skemë ose zhvillim dhe të veprojë si konsulent, menaxher ose zhvillues për çdo skemë apo zhvillim të projektit;
- k) Të blejë ose të shesë, vetëm në emër, për dhe në emër të shoqërisë, të marrë ose lejojë me qira, marrë ose të japë në këmbim ose me qira, ose në mënyrë tjetër të marrë, japë, mbajë ose disponojë të gjithë ose një pjesë të ndonjë interesit në çdo pasuri, pasuri, toka, ndërtesa, shërbime, vullnet i mirë, markë tregtare, dizajne, modele, patentë, të drejtën e autorit ose licencë ose ndonjë pronë tjetër të luajtshme ose të paluajtshme, fizike ose jomateriale të çfarëdo lloji për qëllimin të ose në lidhje me biznesin ose degën e kompanisë;

Me qëllim kryerjen e aktiviteteve të mësipërme, Shoqëria mund të ushtroje veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe jashtë saj e të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës, të ngjashëm, plotësues apo te dobishëm për përmbushjen e objektit të saj. Për përmbushjen e objektit të saj, Shoqëria mund të:

Ulez

- A) Të zotërojë direkt ose indirekt pjesëmarrje në shoqëri dhe/ose sipërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose që mund të ndihmojnë në realizimin e objektit të Shoqërisë;
- B) Të themelojë degë, zyra përfaqësimi dhe në përgjithësi të kryejë çdo aktivitet tjetër që nuk është i ndaluar nga ligji.

NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë “D.U.M PROJECT ALBANIA” SH.P.K, është 200.000 (dyqind mijë) Euro, ku:

- Ortaku Z.Stefano Mari zotëron një kuotë të barazvlefshme me 100% të kapitalit themeltar.

Ky kapital është i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

Kuotat e Ortakëve regjistrohen në librin e regjistrimit të kapitalit të shoqërisë.

NENI 6 ORGANET E SHOQËRISË DHE ASAMBLEJA

Organet drejtuese të shoqërisë “D.U.M PROJECT ALBANIA” Sh.p.k janë:

- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim – marrës.
- Administratori i shoqërisë, i cili është **Z.Luigi Gallo** i datëlindjes 14.11.1976, lindur në Taurianova (RC), Itali, i identifikuar me Numër Pasaporte YB1597709, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

NENI 7

Të drejtat dhe detyrat e Asamblesë, organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë, vendas apo të huaj shprehen në statut i cili së bashku me aktin e themelimit përbëjnë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë shoqëri.

NENI 8

Veprimtarinë e saj, shoqëria do ta zhvillojë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

NENI 9

Të gjitha mosmarrveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore, zgjidhen me mirëkuptim me anë të dispozitave të këtij akti, statutit dhe legjislacionit



shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat, atëhere zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt Themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "D.U.M PROJECT ALBANIA" SH.P.K. në Qendrën Kombëtare të Biznesit Tiranë. Në këtë ditë shoqëria "D.U.M PROJECT ALBANIA" SH.P.K. njihet si person juridik.

Neni 10
Dispozita e fundit

Autorizohet **Z.Luigi Gallo** dhe/ose **Znj.Fabiana Hasanaj** (e bija Bedriut dhe Fatbardhes, e datëlindjes 09.03.1994, lindur dhe banuese ne Tiranë, identifikuar me Nr. Personal ID. J45309050U, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar) të cilët së bashku ose veç e veç do të depozitojnë dokumentacionin dhe të ndjekë të gjitha procedurat për regjistrimin si person juridik të Shoqërisë.

Ky akt themelimi u hartua në tre ekzemplarë me vlera të njëjta juridike dhe pasi iu lexua themeluesit, u nënshkrua rregullisht prej tij.

ORTAKU
Stefano MARI





STATUT
I SHOQËRISË TREGËTARE
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“D.U.M PROJECT ALBANIA” SH.P.K.

NENI 1
FORMIMI

Shoqëria me përgjegjesi të kufizuar “D.U.M PROJECT ALBANIA” Sh.p.k. themelohet në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”. Kjo shoqëri krijohet sipas marrëveshjes së Ortakut dhe Aktit të Themelimit të hartuar prej tyre.

NENI 2
EMËRTIMI, SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë në bazë të këtij Statuti dhe do të ketë emërtimin “D.U.M PROJECT ALBANIA” sh.p.k. Ajo do të ushtrojë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë në bazë të Regjistrimit në Institucionet përkatëse si edhe jashtë saj në bazë të modaliteteve ligjore që kërkohen nga shteti ku do të ushtrojë veprimtarinë.

Selia e Shoqërisë me Përgjegjesi të Kufizuar “D.U.M PROJECT ALBANIA” Sh.p.k. është në adresën: **Rr. “Riza Cerova”, Nd 18, H 5, Njësia Administrative 8, 1017 Tiranë, Shqipëri.**

NENI 3
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjesi të kufizuar “D.U.M PROJECT ALBANIA” SH.P.K. është e pacaktuar. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, kohëzgjatja e aktivitetit mund të zgjatet, të shkurtohet ose të ndërpritet tërësisht ose menjëherë.

NENI 4

Shoqërisë me përgjegjesi të kufizuar “D.U.M PROJECT ALBANIA” Sh.p.k. për detyrimet që do të lindin gjatë aktivitetit të saj me të tretët përgjigjet vetëm me pasuritë e saj. Ortakët e kësaj shoqërie nuk përgjigjen për detyrimet e kësaj shoqërie me pasuritë e tyre që nuk janë futur në kapitalin e kësaj shoqërie. Pjesëmarrja në këtë shoqëri nuk i pengon ortakët të kenë pavarësi ligjore, organizative dhe të drejta pronësie jashtë kësaj shoqërie.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "D.U.M PROJECT ALBANIA" Sh.p.k. do të jetë:

- a) Shërbime telemarketingu. Ofrimin e të gjitha shërbimeve që lidhen me call-center dhe kontakt center duke përfshirë edhe përpunimin e të dhënave të shoqërive të tjera dhe/ose enteve publike, ndërmjetësimin tregtar dhe marketing në fushën e shërbimeve telematike dhe telefonike. Aktivitete të shërbimeve të ndërmjetësimit midis shoqërive private brenda dhe jashtë vendit.
- b) Shërbime trajnimi dhe edukimi në fushën e teknologjisë së informacionit. Shtypshkrime, botime, printime dhe fotokopjime. Përfaqësim të kompanive të huaja që ushtrojnë aktivitet në Shqipëri ose jashtë saj. Të kryejë aktivitet publikimi dhe reklamimi.
- c) Shërbime të menaxhimit të projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.
- d) Krijimi mbajtja dhe mirëmbajtja e faqeve të internetit. Krijimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve informatike dhe aplikimeve të ndryshme. Krijimi i logove të ndryshme si atyre, postare, broshurave, sportive, publicitare dhe çdo gjë tjetër që lidhet me konceptimin, realizimin, promovimin, prodhimin dhe shitjen e tyre në mediën e shkruar, atë vizive dhe atë elektronike.
- e) të prodhojë, përpunojë, blejë, shesë, shkëmbejë, ndryshojë, përmirësojë, importojë, eksportojë ose ndryshe të merret me të gjitha llojet e pajisjeve elektrike, pajisjet për kursimin e energjisë, produktet e energjisë diellore, pajisjet dhe komponentët për përdorim komercial dhe shtëpiak;
- f) Të ofrojë shërbime online dhe offline, si në vend ashtu edhe jashtë saj, për të arritur tek klientët, furnizuesit dhe bashkëpunëtorët e tij, drejtpërdrejtë dhe përmes ndërmjetësve, zëdhënësve, agjencive dhe përfaqësuesve;
- g) Të ofrojë asistencë online dhe telefonike, të zhvillojë faqe-uebi dhe portale, aplikacione mobile dhe e-commerce, për të lehtësuar misionin e saj dhe si shërbim për klientët e saj, sipas nevojës. Kjo do të përfshijë, por pa u kufizuar në, dhënia me qira e pajisjeve elektronike dhe/ose objekteve që kërkohen për aktivitete promovuese.
- h) Të marrin pjesë në tenderat publike dhe private për furnizimin dhe shpërndarjen e të gjitha sendeve që kanë të bëjnë me industrinë e teknologjisë së informacionit, prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve promocionale, si dhe pajisjet e tjera përkatëse;
- i) të pranojë dhe të japë honorare, të drejta, licenca ose prona të ngjashme intelektuale ose të tjera të çfarëdo lloji dhe të lidhë marrëveshje për këtë qëllim;
- j) Të promovojë, financojë, organizojë ose të trajtojë në ndonjë mënyrë tjetër, çdo projekt, skemë ose zhvillim dhe të veprojë si konsulent, menaxher ose zhvillues për çdo skemë apo zhvillim të projektit;
- k) Të blejë ose të shesë, vetëm në emër, për dhe në emër të shoqërisë, të marrë ose lejojë me qira, marrë ose të japë në këmbim ose me qira, ose në mënyrë

tjetër të marrë, japë, mbajë ose disponojë të gjithë ose një pjesë të ndonjë interesi në çdo pasuri, pasuri, toka, ndërtesa, shërbime, vullnet i mirë, markë tregtare, dizajne, modele, patentë, të drejtën e autorit ose licencë ose ndonjë pronë tjetër të luajtshme ose të paluajtshme, fizike ose jomateriale të çfarëdo lloji për qëllimin të ose në lidhje me biznesin ose degën e kompanisë;

Me qëllim kryerjen e aktiviteteve të mësipërme, Shoqëria mund të ushtroje veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe jashtë saj e të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës, të ngjashëm, plotësues apo te dobishëm për përmbushjen e objektit të saj. Për përmbushjen e objektit të saj, Shoqëria mund të:

- A) Të zotërojë direkt ose indirekt pjesëmarrje në shoqëri dhe/ose sipërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose që mund të ndihmojnë në realizimin e objektit të Shoqërisë;
- B) Të themelojë degë, zyra përfaqësimi dhe në pergjithësi të kryejë çdo aktivitet tjetër që nuk është i ndaluar nga ligji.

NENI 6

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, selinë, objektin e veprimtarisë së saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 7

KAPITALI I SHOQËRISË

- Kapitali themeltar i shoqërisë "D.U.M PROJECT ALBANIA" Sh.p.k. është 200.000 (dyqind mijë) Euro.
Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre, si më poshtë:
- Ortaku themelues Z. Stefano Mari, i cili zotëron 1 kuotë me vlerë të përgjithshme 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ky kapital është i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

Kuota e Ortakëve regjistrohet në librin e regjistrimit të kapitalit të shoqërisë.

Ai mund të shtohet apo të reduktohet me vendim të Asamblese së Ortakëve sipas Ligjit 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Kapitali i shoqërisë i kontribuar nga ortakët do të regjistrohet në librin e regjistrimit të kapitalit të shoqërisë.

NENI 8

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar për efekt vlefshmërie duhet të bëhet me Akt Noterial dhe të regjistrohet si te Libri i Shoqërisë ashtu edhe te Zyra e Regjistrimit Tregtar.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Tranferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, jo ortakë, duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 9

Shoqëria cakton nga fitimet e saj një fond rezervë i cili bëhet në masën 5% të fitimeve sipas Ligjit 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Përveç fondit rezervë, shoqëria mund të krijojë edhe fonde të tjera për realizimin e objektivave të saj me miratimin e Asamblesë të Përgjithshme. Shoqëria paguan taksat dhe detyrimet e tjera ligjore përpara Shtetit Shqiptar. Humbjet ose fitimet e mbartura nga viti i kaluar zbriten ose shtohen respektivisht. Mbas aprovimit të llogarive vjetore dhe verifikimit të shumës së parave që do të shpërndahet, Asambleja e Ortakëve vendos pjesët që do t'i shpërndahen ortakëve.

NENI 10

Shoqëria ka të drejtë të lërë peng një pjesë të kapitalit të saj themeltar. Në rast shitje të detyruar të pjesëve të lëna peng, pengmarësi do të pranohet si person të cilit i janë transferuar pjesë të kapitalit, me përjashtim të rastit kur shoqëria preferon t'i blejë ato dhe të deklarojë zvogëlimin e mundshëm të kapitalit themeltar.

NENI 11 **STRUKTURA E SHOQËRISË**

Organi vendimarrës i shoqërisë do të jetë Asambleja e Përgjithshme. Ajo përbëhet nga ortakët e Shoqërisë. Asambleja funksionon sipas përcaktimeve të bëra në këtë statut dhe dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 12

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me ligjin dhe normat e këtij statuti janë të detyrueshme për të gjithë. Ato regjistrohen në librin e shoqërisë.

NENI 13

Çdo i interesuar mund të kërkojë në Gjykatë anulimin e vendimit të Asamblesë së shoqërisë të marrë në kundërshtim me ligjin apo normat e këtij statuti.

NENI 14

Aktiviteti financiar i shoqërisë kontrollohet nga Ekspertët kontabël të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 15

ASAMBLEJA E SHOQËRISË, VENDIMARRJA

Në përputhje me Nenin 81, pika 3, e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", Ortaku ushtron të gjitha të drejtat dhe kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Në mënyrë të veçantë, duhet të regjistrohen vendimet e mëposhtme për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) vendime për investime;
- d) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- e) marrjen përsipër të detyrimeve nga Shoqëria për shumat mbi 15.000 Euro për çdo veprim ose nëse tejkalojnë shumën totale 15.000 Euro në një vit kalendarik.

Çdo vendim i Ortakëve që nuk është regjistruar në regjistrin e vendimeve do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm. Ortakët vendosin për të gjitha çështjet e parashikuara në nenin 81 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*".

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortaku ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencë dhe/ose videokonferencë, në përputhje me ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.

Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga administratori/et ose ortaku i Shoqërisë në përputhje me parashikimet e Nenit 84 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*" dhe sa herë që thirrja është e detyrueshme sipas ligjit. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim, telefax ose letërporosi të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht në rast se, pavarësisht respektimit të formaliteteve të mësipërme, ortakët apo përfaqësuesi/it e tij janë dakord për rendin e ditës dhe të marrin vendime për çështjet përkatëse.

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Ortaku i vetëm i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.

NENI 16 DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqëria do të administrohet nga një administrator i zgjedhur nga Ortaku.



Administratori i vetëm rizgjidhet ose shkarkohet nga Ortakët.

NENI 17

Emri i shoqërisë, administratorit si dhe vula e shoqërisë duhet të figurojnë në të gjitha shkresat zyrtare të shoqërisë si dhe në dokumentat që kanë të bëjnë me përmbushjen e objektit, apo që i shërbejnë ushtrimit të aktivitetit të saj.

NENI 18

Administratori përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët duke zbatuar politikën e drejtimit të shoqërisë. Në raste të veçanta mund dhe të caktojë një person tjetër me prokurë të posaçme ose me autorizim.

NENI 19

Administratori mban përgjegjësi për shkelje të ligjit, statutit, rregullores së brendshme para Asamblesë, të tretëve dhe instancave ligjore.

NENI 20

Në fund të çdo viti, administratori përgatit Raportin vjetor të administrimit dhe i'a paraqet Asamblesë së Ortakëve së bashku dhe me invetaret e llogaritë vjetore.

NENI 21

Administrator i shoqërisë është **z. Luigi GALLO**, mandati i të cilit është 5 vjet.

Administratori ka këto kompetenca:

- përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
- drejton aktivitetin e shoqërisë në bazë të objektit të saj;
- thërret mbledhjes së zakonshme;
- harton dhe paraqet raportin vjetor.

Administratori mban përgjegjësi për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të delegojë të tretë për të kryer veprime dhe akte të caktuara në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast, administratori do të jetë përgjegjës për veprimtarinë e të tretëve që ka autorizuar.

Administratori nuk mund të marrë hua nga Shoqëria apo të lëshojë garanci, dorëzani në emër dhe për llogari të Shoqërisë për hua dhe financime të dhëna nga të tretët.

Ortakët përcaktojnë shpërblimin e organit administrues të Shoqërisë. Organi administrues do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikt interesi, administratori i përfshirë do të njoftojë menjëherë Asamblesë e Përgjithshme si edhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me situatën e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.



NENI 22 **BILANCI DHE FITIMET**

Viti financiar i shoqërisë mbyllet më datë 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori bën inventarin dhe llogaritë vjetore sipas dispozitave të kontabilitetit dhe harton një raport me shkrim për administrimin. Bilancit i bashkohet:

- një situacion për garancitë e dhëna nga shoqëria;
- një situacion për sigurimet e bëra nga shoqëria.

NENI 24

Përderisa "rezerva e domosdoshme" të arrijë 1/10 pjesë të kapitalit themeltar, shoqëria është e detyruar të depozitojë 1/20 e fitimit të realizuar.

NENI 25

Fitimet pasi të jenë depozituar, shumat e urdhëruara për rezervën e të tjera, i takojnë ortakëve të shoqërisë.

NENI 26

Raporti vjetor financiar i paraqitet ortakut për aprovim para 31 marsit të vitit pasardhës. Raportet 3 mujore financiare do t'i paraqiten Mbledhjes së Asamblesë brenda 30 ditëve nga mbyllja e tre mujorit.

NENI 27

Në rast të likuidimit të shoqërisë, caktohet likuidatori duke qënë i detyruar të njoftojë për punët e shoqërisë.

NENI 28 **MARRËDHENIET E PUNËS**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet dispozitave të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Të gjithë personat e punësuar në shoqëri kanë të drejtë të përcaktojnë marrëdhëniet e punës nëpërmjet Kontratës së Punës dhe Kontratës Kolektive të Punës.

NENI 29

Mosmarrëveshjet e punës zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor kur mjetet e tjera nuk japin rezultat. Shoqëria respekton rregullat e punësimit dhe të Sigurimeve Shoqërore, ndërsa të punësuarit janë të detyruar që t'i pranojnë e zbatojnë ato. Të gjithë të punësuarit janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës.

NENI 30

Asambleja e shoqërisë përcakton përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, organet gjyqësore, caktimin e avokatit si edhe në marrëdhëniet me sistemin fiskal e organet e tjera shtetërore.

NENI 31

E gjithë veprimtaria e shoqërisë në aspektin ekonomik, drejtohet nga Administratori i shoqërisë. Pjesëmarrja me shoqëri të tjera, ndryshimi i statutit, kapitalit themeltar, miratimi i bilancit, pranimi i ortakëve të rinj, përcaktohet nga Asambleja e Ortakut.

NENI 32

MBARIMI I SHOQËRISË

Veprimtaria e shoqërisë mbaron me vendim të Asamblesë së Ortakut në rastet e parashikuara në ligj.

NENI 33

LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Shoqëria likujdohet sipas procedurave të mëposhtme në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Kur shoqëria kalon në procedurën e likuidimit, Asambleja e Ortakëve cakton komisionin e likuidimit i cili do të dorëzojë për aprovim bilancin përfundimtar të likuidimit dhe dokumentat e lidhura me të Asamblesë së Ortakëve. Shoqëria pushon veprimtarinë e saj dhe mbyllja e shoqërisë do të regjistrohet në regjistrin tregtar.

Pasuria e shoqërisë, pasi shlyhen detyrimet e shoqërisë, i kalon ortakëve të shoqërisë sipas kapitalit themeltar.

NENI 34

Likuidimi i shoqërisë vendoset me vendim të Asamblesë së Shoqërisë, e cila për të kryer veprimet që kërkohen, emëron një likuidator me tagrat e përcaktuara në Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Likuidatori është përgjegjës si ndaj shoqërisë ashtu dhe ndaj të tretëve. Ai shpërblehet në bazë të vendimit të Asamblesë të shoqërisë.

NENI 35

Likuidatori i emëruar përfaqëson shoqërinë dhe nënshkruan duke vënë firmën nën vulën e shoqërisë. Ai duhet të përfundojë shitjet që janë të disponueshme për llogari të



shoqërisë, të marrë nga çdo debitor llogari të sakta në monedhë dhe të kthejë pasurinë e shoqërisë në para. Për çështjet e mbetura pezull vendos Asambleja e shoqërisë për zgjidhjen e tyre. Në përfundim të likuidimit të shoqërisë, likuidatori përpilon bilancin përfundimtar dhe nxjerr buletin përkatës.



NENI 36
DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Përsa nuk është shprehur në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe çdo dispozite e Legjislacionit Shqiptar që gjen vend në këto marrëdhënie juridike e tregtare.

NENI 37

Shoqëria fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë.

ORTAKU
Stefano MARI

NR 359 REP



VERTETIM NOTERIAL

Në Tiranë, sot më date 02/10/2018 (dymijë e tetembedhjete) në Zyrën e Noterisë Tiranë, Bulevardi "B.Curri", pallati Aviacionit, Hyrja 3, Ap 17, para meje noteres Blerina MUSTAFARAJ, u paraqit personalisht pala me identitetin e mëposhtem:

1. Z.Stefano Mari, i biri i Maurizio-s dhe Virginia-s, i datëlindjes 22.12.1981, lindur në Tradate (VA), Itali, banues në Adresën Via. Garibaldi, 58, 22070 Locate Varesina (CO) Itali, i identifikuar me Numër Pasaporte YA2779546, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

I cili, ne cilësinë e themeluesit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "D.U.M PROJECT ALBANIA" SH.P.K. më deklaroi se dokumenti i bashkëlidhur këtij vërtetimi është AKT THEMELIMI dhe STATUTI i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "D.U.M PROJECT ALBANIA" SH.P.K., i cili është hartuar dhe nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë.

Meqënëse themeluesi i kësaj Shoqërie është shtetas italian, kërkoi që komunikimi të bëhet në gjuhën italiane. Akti i mësipërm iu përkthye fjalë për fjalë nga gjuha shqipe në gjuhën italiane nga përkthyes Ervin Çollaku, dhe si deklaroi se e kuptoi saktë dhe qartë përmbajtjen saj e nënshkroi pa vërejtje.

Unë noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.



**NOTERE
BLERINA MUSTAFARAJ**